
 REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY		
Dep. Dep. DPK/OMP Dep.	Nr. Prot. Br. Prot. 03-1309/2012 Prot No.	Data Datum 01.04.2012 Date
Nr. Filaq. Broj stranica Nr. pages 02	Prishtinë	

Nr.regj. 24906/2011

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën për kundërvajtje kundër të pandehurit Avni Murati nga Podjeva, për kundërvajtje nga neni 6.2 ndëshkuar me nenin 16 paragr. 1.1 dhe neni 7.1 ndëshkuar me nenin 16 paragr.1.2 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publik e Pasurisë, Nr. 03/L-151, në bazë të nenit 73,74, 195 dhe nenit 198 al.1 pika 8 të Ligjit mbi Kundërvajtjet GZK 23/79, me datë **05.03.2012** merr këtë:

AKTVE N D I M

PEZULLOHET procedura kundërvajtëse kundër të pandehurit Avni Ramadan Murati, i lindur më 15.07.1969 në fshatin Shakovicë, Komuna Podujevë, ku edhe tani jeton, Auditor i Brendshëm në kompaninë "Hekurudhat e Kosovës Sh A" në Prishtinë, me shkollim superior, i martuar, babë i katër fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, për kundërvajtjet nga neni 6.2 e ndëshkuar me nenin 16 paragr.1.1 dhe nenit 7.1 e ndëshkuar me nenin 16 paragr.1.2 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik,

Pezullimi bëhet komfor nenit 198 al.1 pika 8 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, në mënyrë të provave.

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur.

Nga një kopje e këtij aktvendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës dhe Avni Muratit.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsion në Prishtinë, i parashtror kësaj gjykate kërkesën 01/3197/2011 me datë 19.07.2011 për fillimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurit të lartshënuar për kundërvajtjen e precizuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi, me arsyetim se i njëjti në Agjencinë Kundër Korrupsion nuk e ka dorëzuar formularin mbi deklarinimin e pasurisë me marrjen e detyrës e as deklarinimin e rregullt të gjendjes së pasurisë deri më datën 31.03.2011.

Në bazë të kërkesës së parashtruar, gjyqtarja filloi procedurën kundërvajtëse, mori në pyetje të pandehurin i cili në mbrojtjen e vet deklaroi se me SHA "Hekurudhat e Kosovës" ka themeluar marrëdhënie pune në afat të caktuar duke filluar prej datës 01.11.2010 gjer më datën 31.10.2011, mirëpo as në bazë të kontratës së punës, as nga sekretari si pikë kontaktuese në kompaninë "Hekurudhat e Kosovës", e as në ndonjë mënyrë tjetër nuk ka qenë në dijeni se i takon kategorisë së zyrtarëve të lartë dhe se ka obligim të bëjë deklarinimin e pasurisë.

Për të vërtetuar gjendjen e plotë dhe të drejtë faktike, gjyqtarja dëgjoi edhe parashtruesin e kërkesës, zyrtarin e AKK sipas autorizimit të datës 02.11.2011, në cilësi të dëshmitarit, i cili ritheksoi se në bazën e shënimeve të AKK, zyrtari Avni Murati shihet se fare nuk ka bërë deklarinimin e pasurisë. Në vazhdim gjyqtarja dëgjoi edhe sekretarin e kompanisë "Hekurudhat e Kosovës" si pikë kontaktuese midis kompanisë dhe zyrtarëve të saj dhe AKK, në cilësi të dëshmitarit, i cili deklaroi se nuk është i sigurt nëse e ka njoftuar auditorin Avni Muratin me njoftimin për deklarinimin e pasurisë, kurse siç premtoi, pas ca ditësh gjykatës i siguroi ca parashtruesin si kopje të emailit zyrtar të datës 08.03.2011 nga Xh.Ramosaj drejtuar zyrtarëve të lartë të kompanisë "Hekurudhat e Kosovës" ku emri i auditorit Avni Murati nuk është i shënuar fare. Gjithashtu si shtesë kishte siguruar edhe një deklaratë me shkrim të nënshkruar personalisht nga vet auditori Avni Murati, i cili sërish kishte deklaruar se nuk ka qenë i njoftuar për obligimin për deklarinimin e pasurisë, si dhe një vërtetim me të cilin shihet se i njëjti ka bërë deklarinimin e pasurisë me vonesë, saktësisht me datë 20.09.2011 në AKK. Gjithashtu dëshmitari, sekretari R. Morina ka siguruar edhe deklaratën me shkrim të nënshkruar personalisht nga ai vet, në të cilën shihet deklarimi i tij se nuk posedon të dhënë zyrtare e cila dëshmon se i njëjti, pra sekretari R.Morina e ka njoftuar auditorin Avni Murati për obligimin për deklarinimin e pasurisë.

03-1308/2012/02

fung

Nga të dhënat në kërkesë, vlerësimi i deklaratës së të pandehurit, dëshmitarëve dhe provave materiale, administrimi i tyre veç e veç dhe të gjitha së bashku, gjyqtarja në masë të mjaftueshme vërtetoi gjendjen e plotë dhe të drejtë faktike, se i pandehuri nuk ka qenë në dijeni për obligimin që ka pasur për deklarimin e pasurisë, andaj duke konstatuar se nuk ka gjetur prova për të vërtetuar se Avni Murati ka kryer kundërvajtjet me të cila është ngarkuar, komfor nenit 198 parag.1 pika 8 të LK në mungesë të provave ka bërë pezullimin e procedurës kundërvajtëse për të dy kundërvajtjet ndaj Avni Muratit, auditor i brendshëm në kompaninë "Hekurudhat e Kosovës" në Prishtinë.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

U VENDOS NË GJYKATËN KOMERCIALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË

Nr.regj.24906/2011, datë 05.03.2012

Gjyqtarja

Suzana Çerkini



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, nga data e pranimit të njëjtit nëpërmjet kësaj gjykate, pa taksa.